


v



RAPORT TEMATIK

Vështirësitë që hasin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollim



Qershor 2019, Prishtinë

Raport tematik

Vështirësitë që hasin nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollim

Ky raport është hartuar nga Samir Shahini me mbështetjen e projektit “Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020” të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Balkan Sunflowers (BSFK), Syri I Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC).

Pikëpamjet e shprehura në këtë vlerësim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal ose pjesëmarrësve të tij, e as të Bashkimit Evropian dhe Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

Qershor 2019, Prishtinë

1 Tabela e përmbajtjes

2	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
3	HYRJE	5
4	KONTEKSTI	6
5	ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË KOSOVË	8
6	KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI I ARSIMIT NË KOSOVË.....	9
6.1	Ndërlidhja në mes të politikave qeveritare.....	9
1.1.	Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021	9
	Agjenda për Reforma Evropiane	10
1.2.	Programi për Reforma Ekonomike (PRE).....	10
1.3.	Programi Qeverisës i Republikës së Kosovës 2017-2021.....	11
1.4.	Strategjia Kombëtare për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021	11
7	ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË SISTEMIN ARSIMOR.....	12
8	QENDRAT MËSIMORE NË KOSOVË	14
9	METODOLOGJIA HULUMTUESE.....	15
10	REZULTATET E HULUMTIMIT.....	16
10.1	Faktorët ekonomik.....	18
10.2	Çështje shëndetësore, që ndërlidhen me edukimin	20
10.3	Çështje sociale.....	22
10.4	Probleme në të mësuar.....	25
10.5	Diskriminimi	28
10.6	Gjuha.....	30
10.7	Qasja	31
11	REKOMANDIME.....	32

LISTA E SHKURTESAVE

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BSFK - Balkan Sunflowers Kosova

BIRN - Balkan Investigative Reporting Network

KEEN - Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim

KOSINT - Projekti “Iniciativa e Kosovës për Integrim 2020”

MASHT - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

QM - Qendra Mësimore

OJQ - Organizata Jo-Qeveritare

PSAK - Plani Strategjik për Arsim në Kosovë

RADC - Roma and Ashkali Documentation Center

TDH - Terre Des Hommes

TIP - The Ideas Partnership

UA - Udhëzimi Administrativ

VoRAE - Voice of Roma, Ashkali and Egyptians

SKZH - Strategjia Kombëtare për Zhvillim

2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përgjithësi mund të konstatohet se pozita e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë nuk ka shënuar përmirësim të kënaqshëm, gjë e cila është dokumentuar edhe në raporte të ndryshme të publikuara nga organizata dhe institucione vendore, por edhe nga ato ndërkombëtare. Për më tepër, edhe pse situata vlerësohet të ketë pasur përmirësim të lehtë nga palët e përfshira në këtë hulumtim, duke filluar nga vetë nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian, prindërit e tyre, mësimdhënësit e tyre, dhe udhëheqësit e shkollave në komunat përkatësetë përzgjedhura për të realizur hulumtimin, në të njëjtën kohë raportohen shumë probleme dhe sfida të cilat edhe pse në vazhdimësi janë raportuar nuk kanë gjetur zgjidhje.

Qëllimi i këtij studimi është të ofrojë informacione dhe analiza lehtë të kuptueshme, kryesisht kualitative, për këto probleme dhe sfida me të cilat përballen nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian në shkolla. Të dhënat në këtë raport janë mbledhur kryesisht nga dokumente të publikuara nga MASHT, OJQ të cilat angazhohen dhe monitorojnë zhvillimin e edukimit parashkollor në Kosovë, por edhe nga vetë shkollat.

Edhe më tutje, Kosova mbetet me nivelin më të ulët të përfshirjes së fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në edukimin e institucionalizuar, ndërsa nuk vërehet përpjekje serioze e cila në një të ardhme të afërt do të përmirësonte këtë gjendje. Të dhënat zyrtare tregojnë se norma bruto e regjistrimit në arsimin e detyruar është pak mbi 84.9%, ndërsa bie ndjeshëm në 30% në arsimin sekondar të lartë¹. Mbetet i largët synimi për eliminimin e diskriminimit dhe racizmit në shkolla, sidomos në ato shkolla që punojnë ndarazi në sistemin paralel serb ku ende ka klasa të segreguara, sigurimin e programeve edukative cilësore, përfshirjen e prindërve të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian, faktor këta të cilët do të siguronin përfshirjen plotë të fëmijëve në shkollimin fillor, dhe përgatitjen e duhur të fëmijëve për shkollimin e mëtejshëm.

Hulumtimi ofron dëshmi për situatën aktuale dhe jep rekomandime të cilat do të shpiejnë drejt përmirësimit të kësaj situatë në edukim në këtë nivel, kur dihet se të gjitha vendet e zhvilluara vite më parë kanë rritur investimet në edukimin e fëmijëve dhe rritjen e përfshirjes, dhe në këtë mënyrë kanë arritur të shënojnë rezultate të prekshme në të ardhmen e gjeneratave.

Ky raport synon të informojë opinionin publik në lidhje me situatën në të cilën ndodhemi por edhe të rrisangazhimin e të gjitha palëve, në veçanti të institucioneve, që të investojnë në edukimin cilësor dhe gjithëpërfshirës të fëmijëve në Kosovë.

1. Këshilli e Evropës, 2015 - Udhëzime për mësimdhënësit për gjithëpërfshirjen sociale të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në shkolla

3 HYRJE

Duke besuar se një shoqëri mund të zhvillohet në plotni vetëm atëherë kur të gjithë individët janë përfshirë në sistemin e edukimit, ky hulumtim analizon sfidat specifike të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian në shkolla në Kosovë. Pavarësisht një numri të madh të ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve tjera që mbrojnë të drejtat e fëmijëve përbrenda legjislacionit të Kosovës, fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të jenë të prekur nga niveli i ulët i përfshirjes, duke u bërë kështu, në numra të lartë, viktimë e braktisjes së hershme të shkollimit.

Procesi i përfshirjes të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin e arsimit është adresuar nëpërmjet një sërë ligjesh, dy strategjive, dhe disa udhëzimeve administrative. Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 e miratuar në Prill të vitit 2017 nga Qeveria e Kosovës, e parasheh arsimin si një nga katër shtyllat kryesore të intervenimit. Në fushën e arsimit, ka një numër aktivitetimesh të cilat janë paraparë të adresohen në vitet e ardhshme. Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017- 2021 gjithashtu parasheh masa konkrete për rritjen e pjesëmarrjes dhe cilësinë e arsimit për komunitetet e cënueshme, me një fokus te fëmijët nga komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.


Në anën tjetër një numër i konsiderueshëm i organizatave jo-qeveritare kanë zhvilluar programe të ndryshme të ofrimit të ndihmës në mësim-nxënie për nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian, programe të ndërmjetësimit me komunitet, si dhe programe të përkrahjes së të rinjëve në lokacione të ndryshme në Kosovë ku janë të përqëndruara këto komunitete.

Megjithatë, të gjitha këto masa të lartë-përmendura nuk kanë mjaftuar për të përafuar në nivelin e dëshirueshëm komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me komunitetet tjera në Kosovë në fushën e arsimit.

Fillimisht në hulumtim është paraqitur një pasqyrë e shkurtër e profilit të secilit nga të tri komunitetet. Së dyti, është paraqitur infrastruktura ligjore që mbulon fushën e edukimit, të të drejtave të njeriut - me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve, të drejtave të komuniteteve etnike jo-shumicë, si dhe aspektet zhvillimore të vendit. Në fund janë detajuar rezultatet e hulumtimit të realizuar në katër komuna të Kosovës, si dhe një numër rekomandimesh të cilat kanë dalur si përmbledhje e kontributeve të të gjithëve

4 KONTEKSTI

Të dhënat për popullsinë e përgjithshme dhe ato të komuniteteve etnike vijnë nga regjistrimi i fundit i popullsisë i kryer në vitin 2011 (Të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës). Një total prej 8,824 ose 0,5% të popullsisë së përgjithshme janë rom, 15,436 (që është 0,9% e popullsisë së përgjithshme) janë ashkali dhe 11,524 (0,7% e popullsisë së përgjithshme) janë egjiptian.



Grafiku 1 – Popullsia rome, ashkali, dhe egjiptiane në Kosovë

Këto komunitete vazhdojnë të jenë grupi më pak i përfshirë në arsimin fillor, dhe shumë pak i përfshirë atë të mesëm dhe të lartë. Gjithashtu, fëmijët rom, ashkali, dhe egjiptian janë ata të cilët përbëjnë pjesën më të madhe të fëmijëve që ose kanë braktisur shkollimin, ose janë në rrezik braktisjeje.

Në bazë të Ligjit, arsimi para-universitar përfshinë fëmijët e moshës 6-18 vjeç përgjatë tri niveleve të arsimit parauniversitar: shkolla fillore (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (klasa 6-9), shkolla e mesme e lartë (klasa (10-12/13), ku dy nivelet e para janë pjesë e shkollimit të obliguar.

Përveç faktit se të drejtat themelore janë garantuar ngakushtetuta e vendit dhe të drejtat për arsim janë të bazuara në ligjin për arsimin para-universitar si legjislacion ombrellë në arsim, ekzistojnë edhe një numër ligjesh që drejtpërsëdrejti prekinmbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut:

- Ligji përmbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë (03/L-047);
- Ligji për arsimin në komuna i cili parasheh një përgjegjësimë tëmadhe për vendimmarrjen e nivelit lokal (03/L-068);
- Ligji kundër diskriminimit (2004/3);
- Ligji për përdorimin e gjuhëve(02/L37);
- Ligji për trashëgiminë kulturore(02/L-88);

Kosova përgjithësisht mund të konsiderohet si një vend që i ka dhënë një fokus të kënaqshëm promovimit të diversitetit dhe të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit e saj, pavarësisht racës, përkatësisë etnike apo fesë, së paku në kornizën ligjore të saj. Megjithatë, situata në teren tregon se mungojnë ose janë të pafuqishëm mekanizmat për zbatimin e kësaj kornize ligjore.

5 ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË KOSOVË

Komuniteti rom jeton në tërë Kosovën, me përqendrim kryesisht në komunat e Prizrenit, Pejës, Graçanicës, Gjakovës, Obiliqit dhe Mitrovicës. Të dhënat zyrtare tregojnë për 8,824 qytetarë rom në Kosovë. Shumica e romëve janë myslimanë sunitë dhe flasin gjuhën rome, gjuhë kjo që dallon nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Në disa komuna, komuniteti romë përbën ndërmjet 2% dhe 5% të popullsisë komunale.²

Komuniteti ashkali është më i madhi nga këto tre komunitete me 15,436 pjesëtarë. Komuniteti ashkali jeton kryesisht në zona urbane, me përqendrim në komunat e Ferizajt, Fushë Kosovës, Lipjanit, Prizrenit dhe Shtimes. Ata përgjithësisht janë myslimanë sunitë dhe flasin gjuhën shqipe.³

Komuniteti egjiptian përbëhet nga 11,524 pjesëtarë ose më pak se 1% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Egjiptianët jetojnë kryesisht në zona urbane me përqendrim në masë të madhe në komunat e Gjakovës, Pejës, Istogut, Deçanit dhe Klinës. Ata janë përgjithësisht myslimanë sunitë dhe flasin gjuhën shqipe si gjuhë amtare.⁴

Komunitetet më të mëdha jetojnë në komunat si Gjakovë (shumica egjiptianë), Fushë Kosovë (shumica ashkalinj), Prizren (shumica romë), Pejë (shumica egjiptianë), Ferizaj (shumica ashkalinj), Lipjan (shumica ashkalinj) dhe Istog (shumica egjiptianë).

Para periudhës 1998/1999 vlerësohet të ketë pasur më së paku 150,000 romë, ashkali dhe egjiptianë që kanë jetuar në Kosovë. Në qytetet si Prishtina, Gjilani, Mitrovica, ku këto komunitete ishin më të përqëndruara para luftës, tani ka mbetur vetëm një përqindje e vogël e popullatës që kanë jetuar aty për shkak të largimit të tyre gjatë dhe pasluftës, dhe vetëm pak prej tyre janë kthyer.

2. Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë: Community Profile: Roma Community. E qasshme në: <http://www.ecmikosovo.org/uploads/Ashkalicommunity1.pdf>

3. Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë: Community Profile: Ashkali Community. E qasshme në: <http://www.ecmikosovo.org/uploads/Ashkalicommunity1.pdf>

4. Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë: Community Profile: Egyptian Community. E qasshme në: <http://www.ecmikosovo.org/uploads/Egyptiancommunity1.pdf>

6 KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI I ARSIMIT NË KOSOVË

Arsimi ka rol të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të një vendi, duke iu mundësuar kështu individëve të shfrytëzojnë potencialin e tyre dhe të luajnë rol produktiv në zhvillimin e shoqërisë. Si i tillë, përveç në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021⁵, arsimi zë vend prioritar në dokumente të ndryshme strategjike të Qeverisë së Kosovës, përfshirë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillimit (SKZh)⁶, Agjendën për Reforma Evropiane (ARE)⁷, Programin për Reforma në Ekonomi (PRE), Strategjinë për Përfshirje të Komuniteteve Rom, dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021, dhe Programin Qeverisës të Republikës së Kosovës.

6.1 NDËRLIDHJA NË MES TË POLITIKAVE QEVERTARE

1.1.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 – 2021

Është dokument bazë strategjik që adreson politikat zhvillimore të rëndësishme të veçantë, duke përcaktuar kështu masat dhe aktivitetet konkrete për një periudhë afatmesme. Fusha e arsimit, si një ndër fushat prioritare është trajtuar në kapitullin e parë të Strategjisë - Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor. Në kuadër të kësaj shtylle janë paraparë masat që kanë të bëjnë me rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin parauniversitar, ndërlidhjen e arsimit me nevojat e tregut të punës, forcimin e llogaridhënies përmes inspektimit, vlerësimin e performancës dhe testeve të jashtme, si dhe me optimizimin e shpenzimeve në arsim përmes sistemeve të të dhënave.

5. *Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021*: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

6. *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021*: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

7. *Agjenda për Reforma Evropiane*: <https://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf>

2.1.1 Agjenda për Reforma Evropiane

është dokument strategjik në të cilin janë përcaktuar masat dhe aktivitetet konkrete afatshkurtra për tri fusha prioritare: qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit; konkurrueshmërinë dhe klimën e investimeve; si dhe arsimin dhe punësimin.

Në kuadër të fushës së arsimit për periudhën 2016 – 2017, ARE parasheh tri masa, si në vijim:

- Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit.
- Përmirësimi i cilësisë së arsimit, nëpërmjet:
 - a. Rritjes së vijueshmërisë së edukimit parashkollor;
 - b. Realizimi i vlerësimit të jashtëm dhe përsheptimi i zbatimit të kurrikulave të reja, përfshirë tekstet e reja shkollore në arsimin para-universitar;
 - c. Krijimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe në shërbim të mësimdhënësve;
 - d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë;
 - e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë institucionet e arsimit të lartë mbi rëndësinë e kurrikulave mësimore, identifikimi i mangësive në shkathtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvojë në punë praktike për studentët;

3.1.1 Programi për Reforma Ekonomike (PRE)

përcakton prioritetet e Qeverisë për përmbushjen e obligimeve kryesore të Kosovës nga MSA8 në fushën e ekonomisë. Në këtë drejtim, objektivi kryesor i Kosovës për fushën e arsimit është ndërlidhja e arsimit dhe aftësimin me kërkesat e tregut të punës, i cili është në harmonizim me SKZH, ARE dhe PSAK.

8. MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit. Më tepër informata në <https://www.mei-ks.net/sq/procesi-i-stabilizim-asociimit-78>

4.1.1 Programi Qeverisës i Republikës së Kosovës 2017-2021

synon të ndërtojë një model të ri arsimor i cili do të përqendrohet në reforma konkrete nga mësimi parashkollor deri tek avancimet akademike. Në kuadër të këtij programi, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) parasheh pesë objektiva për periudhën katërvjeçare 2017–2021 si në vijim:

1. Reformat në sistemin arsimor;
2. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore;
3. Përshtatja e sistemit arsimor me nevojat e tregut të punës;
4. Bashkëpunimi ndërkombëtar në arsim;
5. Hulumtimi zhvillimi dhe inovacioni.

5.1.1 Strategjia Kombëtare për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali është një vazhdimësi të politikave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për forcimin e karakterit multi-etnik dhe multi-kulturor të shoqërisë kosovare. Gjatë hartimit të këtij dokumenti janë marrë parasysh mësimet e nxjerra nga zbatimi i Strategjisë dhe planit të veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2009-2015⁹, si dhe Korniza e BE-së për strategjitë kombëtare për integrimin e romëve deri në vitin 2020¹⁰. Në bazë të kornizës janë definuar katër fusha të veprimit të cilat duhet të adresohen nga strategjitë kombëtare: arsimi, punësimi dhe mirëqenia sociale, shëndetësia dhe banimi. Hartimi i kësaj strategjie të ndarë në katër fusha, nënkupton që një bashkëpunim i thellë ndër-sektorial në mes të ministrive të linjës për secilën shtyllë, është mëse i nevojshëm.

9. *Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, dhjetor 2008*

10. *Korniza e BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve deri në vitin 2020*

7 ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTIANËT NË SISTEMIN ARSIMOR

Fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë të Kosovës vazhdojnë të përballen me sfida në qasjen në arsim cilësor dhe janë jo-proporcionalisht të prekur nga mosregjistrimi, braktisja, analfabetizmi në shkollë të lartë, si dhe arritje të ulëta arsimore.¹¹ Në tetor të vitit 2012, MASHT-i nxori një Udhëzim Administrativ duke i dhënë institucioneve arsimore në nivel komunal përgjegjësi për themelimin dhe funksionalizimin e “ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e detyrueshëm” (EPRMB).¹² Më tutje, MASHT-i, në tetor 2014, zhvilloi dhe aprovoi termat e referencës për të ndihmuar në operimin e ekipeve EPRMB. Duke qenë të obligueshme në nivel shkolle dhe komune, EPRMB-të mëtojnë të bashkërendojnë veprimet për t’i trajtuar braktisjet dhe për ta luftuar regjistrimin e ulët dhe pritjet nga to të ofrojnë mbështetje të veçantë për fëmijët e këtyre tre komuniteteve.

Në anën tjetër, nuk është arritur progres në adresimin e çështjes së ekzistimit të dy sistemeve të ndara të arsimit që në mënyrë të pashmangshme ndikon në ndarjen edhe më tej të komuniteteve. Përkundër rekomandimeve të ‘Komisionit të pavarur për shqyrtimin e materialeve mësimore gjuhësore në gjuhën serbe të publikuara në vitin 2010 për rëndësinë e një sistemi unik arsimor për të gjitha komunitetet në Kosovë¹³ nuk janë ndërmarrë përpjekje serioze për trajtimin e ofrimit të veçantë të mësimin në gjuhën serbe, kryesisht për shkak të rrethanave të përgjithshme politike. Për më tepër, nuk kamundësi qoftë për nxënësit shqiptarë të Kosovës, qoftë për ata serbë të Kosovës t’i mësojnë gjuhët e komuniteteve numerikisht më të vogla, gjë që do të ndihmonte në ruajtjen dhe promovimin më të mirë të gjuhës dhe kulturës romë në veqanti. Përgjithësisht, reforma e vazhdueshme arsimore në Kosovë ende nuk i ka adresuar këto nevoja të përbashkëta për mësim të gjuhëve, arsimim dhe integrim.

Mundësitë për ndërveprim ndërmjet nxënësve që ndjekin mësimet në dy sistemet e ndara arsimore kufizohen në iniciativa të shpërndara dhe të rralla të ndërmarrë nga organizatat ndërkombëtare apo organizatat jo-qeveritare (OJQ) lokale. Ndërveprimi ndërmjet nxënësve nga komunitete të ndryshme madje edhe brenda vetë sistemit të njëjtë arsimor është i gjithashtu ikufizuar dhe ndonëse ngjarjet

11 Instituti Pedagogjik i Kosovës: Fëmijët jashtë shkollës në Kosovë: Studim bazë për praktikën e parandalimit

dhe reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2014), <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/shqip-small-quality.pdf>

12 Udhëzimi administrativ nr. 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e detyrueshëm, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8222>

13 Komisioni i pavarur i MASHT për shqyrtimin e materialeve mësimore në serbisht, f. 15, në: <http://archive.erisee.org/sites/default/files/>

[%20Comprehensive%20Report%20of%20Independent%20Commission%20for%20the%20review%20of%20serbian%20language%20teaching%20materials.pdf](http://archive.erisee.org/sites/default/files/%20Comprehensive%20Report%20of%20Independent%20Commission%20for%20the%20review%20of%20serbian%20language%20teaching%20materials.pdf)

e përgjithshme kulturore dhe sportive organizohen nga vetë shkollat, aktivitetet me qëllim promovimin e dialogun dhe kontaktin ndëretnik organizohen kryesisht nga OJQ-të.¹⁴

Ndërkohë që hartuesve të politikave arsimore ende u duhet të bëjnë dispozita të qarta për të promovuar dialogun ndëretnik dhe kontaktin ndërmjet komuniteteve, një zhvillim pozitiv është referenca në promovimin e diversitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor në Strategjinë ndërministrrore për qeverisje lokale 2016–2021¹⁵. Strategjia parashikon plane komunale të veprimit për promovimin e diversitetit etnik dhe gjuhësor, duke përfshirë mësimin në gjuhë lokale, aktivitete kurrikulare për multikulturalizëm dhe të drejta të njeriut, si dhe aktivitete të përbashkëta ekstrakurrikulare për t'i bërë së bashku nxënësit nga komunitete të ndryshme.

Një dokument i një rëndësie madhore është edhe udhëzimi administrative për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore 19/2018, i cili do të elaborohet më detajisht në vazhdim.

*14*Disa nga organizatat që veprojnë në këtë fushë janë Balkan Sunflowers Kosova (BSFK), Voice of Roma, Ashkali, and Egyptians (VoRAE), Roma and Ashkali Documentation Center (RADC), dhe Terre des hommes (TDH).

*15*Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_per_veteqeverisje_lokale_shq,ser,ang.pdf

8 QENDRAT MËSIMORE NË KOSOVË

Roli i Qendrave Mësimore është të ofrojnë shërbime plotësuese ose alternative arsimore për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian në lokalitetin ku ushtron veprimtarinë, me qëllim të përfshirjes dhe përmirësimit të performancës së tyre në shkollë dhe integritet të tyre në shoqërinë e gjerë. Qendrat Mësimore funksionojnë me bazë në komunitet dhe me bazë në shkollë. Aktualisht, mbi 50 Qendra Mësimore veprojnë në 20 komuna të Kosovës, kryesisht në komunat ku jetojnë shumica e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto qendra udhëhiqen nga mëse 10 organizata të shoqërisë civile në Kosovë me mbështetje financiare kryesisht të donatorëve ndërkombëtar, por vërehet edhe një rritje në mbështetje financiare nga institucionet. Numri më i madh i Qendrave Mësimore është në komunat e Gjakovës, Prizrenit, Pejës dhe Lipjanit.

Sipas të dhënave të ofruara nga organizatat jo-qeveritare që menaxhojnë Qendrat Mësimore, janë gjithsej 5,555 fëmijë që vijnë në aktivitetet në Qendra Mësimore, ku numri i fëmijëve nga të dy gjinitë është pothuajse i barabartë. Komunitet e Fushës Kosovës, Gjakovës dhe Shtimes kanë numrin më të madh të fëmijëve që vijnë në aktivitetet në Qendra Mësimore. Qendrat Mësimore operojnë kryesisht nëpërmjet mbështetjes financiare nga donatorët, dhe kjo mbështetje nuk është e qëndrueshme. Buxheti vjetor i të gjitha Qendrave Mësimore është €1,807,750.40, ndërsë bashkëpunuesit dhe shpenzimeve vjetore të gjitha Qendrave Mësimore për kokë nxënësi është 325,4 EUR apo 27,1 EUR nëmuaj. Përkundër që në Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali parashihet mbështetja e punës së Qendrave Mësimore, MASHT nuk ka ndarë mjete financiare për këtë qëllim.¹⁶

Në fund të muajit gusht 2017 është aprovuar udhëzimi administrativ 12/2017 mbi themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore, dokument ky i cili është reviduar në shtator të vitit 2018, dhe aprovuar në dhjetor të po të njëjtit vit. Udhëzimi i ri administrativ me numër 19/2018¹⁷, tashmë është përcjellur edhe nga hartimi i një udhëzuesi i cili përcakton format e planifikimit, regjistrimit, financimit, vlerësimit dhe raportimit në MASHT dhe në nivel komunal. Ky udhëzim do t'i vë përfundimisht në hartë qendrat për mësim nxënie dhe do tu siguroj njohje dhe mbështetje institucionale. Për më tepër, vitin e kaluar në buxhetin e MASHT është bartur një shumë prej 500,000.00 EUR nga thesari i shtetit, për të mbështetur vazhdimin e punës së qendrave, shumë kjo e cila deri në momentin e hartimit të këtij raporti, nuk është vënë në funksion të organizatave që menaxhojnë me këto qendra.

¹⁶Informata të huazuara nga raporti "Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim", publikuar nga projekti KOSINT në nëntor 2018: http://keen-ks.net/site/assets/files/1446/qm_ne_kosove-_alb-1.pdf

¹⁷Udhëzimi Administrativ 19/2018 për themelimin dhe funksionimin e qendrave mësimore <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-per-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>

9 METODOLOGJIA HULUMTUESE

Metodologjia e përdorur për këtë raport tematik mbi vështirësitë e nxënësve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në shkollim, me përqëndrim nëkomunat e Fushë Kosovës, Shtimes, Obiliqit, dhe Prizrenit, duke u bazuar në të dhënat nga raportet dhe statistikat në dispozicion në nivelkombëtar dhe nivel komunal në njërin anë dhe të dhënat e mbledhura nga komunat më lartë për qëllime të këtij vlerësimi të veçantë në anën tjetër. Raportet që u analizuan për të mbledhur të dhëna për këtë vlerësimpërfshinin:

- Raportet statistikore të MASHT për vitin 2016, 2017 dhe 2018 (të cilat dalin nga divizioni SMIA);
- Raporti i projektit KOSINT 2020 - Integrimi i komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në sistemin arsimor në Kosovë
- Raporti i vlerësimit të të drejtave të komuniteteve në Kosovë nga OSCE, 2015
- Raporti i projektit KOSINT 2020 - Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim
- Raporti vjetor i projektit KOSANA për vitin 2015
- Raporti nga organizata The Ideas Partnership mbi fenomenin e martesave të hershme te komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian në Fushë Kosovë
- Raporti mbi numrin dhe nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, 2018 (Projekti EDI 2)

Ndërkaq, të dhënat nga terrenjanë mbledhur përmes organizimit të katër fokus grupeve në secilën nga katër komunat e përzgjedhura për hulumtim – Fushë Kosovë, Prizren, Obiliq, dhe Shtime. Komunat janë përzgjedhur në dakordim të ngushtë me koordinatoren e projektit KOSINT dhe personat tjerë të përfshirë në projekt.

Fokus grupet janë organizuar me nxënës të shkollave fillore në komunat përkatëse, me prindër të nxënësve të ciklit fillor, mësimdhënës në përbërje të kombinuar në mes atyre klasor dhe ciklit të lartë 6-9, si dhe me menaxhment të shkollave, përkatësisht me drejtor të shkollave. Fokus grupet kanë qenë të përbëra nga 2 e më shumë pjesëmarrës, por jo më tepër se 8 persona në secilin format. Pyetësi ishte i përbërë i përbërë nga një grup prej 8-9 pyetjesh bazë, varësisht nga grupi, mbi të cilat janë zhvilluar biseda të thella me pjesëmarrësit për të nxjerrë informata më të plota dhe më reale nga situata në teren.

Në mënyrë që informatat e nxjerrura nga fokus grupet të jenë më të plota dhe me të sakta, intervistat janë incizuar me zë, të cilat pastaj janë transkriptuar me kujdes. Në të gjitha rastet, incizimi është bërë pasi që të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar me këtë format të intervistimit. Të dhënat nga transkriptat e incizimeve të fokus gupeve janë vendosur në një matriks të detajuar, dhe pastaj nga ky matriks janë nxjerrë të dhënat kualitative dhe ato kuantitative të hulumtimit.

10 REZULTATET E HULUMTIMIT

Nga hulumtimi që është realizuar mbi raporte dhe të gjetura nga hulumtime paraprake, e më pastaj edhe përmes fokus grupeve të realizuara në katër komuna të ndryshme të Kosovës, del që nxënësit kosovar përgjithësisht përballen me sfida të shumta në rrugëtimin e tyre të edukimit. Mungesa e hapësirave të përshtatshme për punë në disa shkolla, numri i madh i nxënësve në klasa, distanca nga shkolla, kushtet ekonomike dhe sociale të familjeve, janë vetëm disa nga sfidat me të cilat nxënësit përballen në Kosovë. Tutje, hulumtimi ka nxjerrë në pah faktorë dhe pengesa të shumta me të cilat nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian përballen në veçanti.

Sipas një studimi të Agjencisë së Statistikave të Kosovës¹⁸ niveli i lexim-shkrimit të komunitetëve rom, ashkali dhe egjiptian është shumë i ulët në krahasim me popullatën shumicë, dhe e njëjta gjë vlen për nivelin arsimor të komuniteteve.

Niveli i arsimimit të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në komunën e Fushë Kosovës për shembull, është shumë i ulët. Sipas rezultateve të hulumtimit nga The Ideas Partnership, nga 502 respondent të intervistuar, 31% e tyre kanë përfunduar vetëm shkollën fillore, 14% e tyre kanë përfunduar shkollën e mesme, ndërsa 29 % e respondentëve janë pa shkollë, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e sistemit arsimor të Kosovës. Kurse vetëm një respondent ka ndjekur studimet në universitet.

Të dhënat kryesore të këtij studimi që kanë të bëjnë me nivelin arsimor të komuniteteve janë prezantuar në vijim:

Aftësia për lexim shkrim – Përqindja e të rinjve të moshës 15-24 vjeçare që janë në gjendje të lexojnë fjali të shkurta rreth jetës së përditshme ose që kanë vijuar arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë:

(a) Femra – 72.8 % (98% në nivel të Kosovës).

(b) Meshkuj – 86.5 % (97.6% në nivel të Kosovës).

Vijueshmëria e arsimit në moshë të hershme - Përqindja e fëmijëve të moshës 36-59 muajsh që vijojnë ndonjë program të arsimit parashkollor: 16.1% (13.9% në nivel të Kosovës).

Përgatitja për shkollë - Përqindja e fëmijëve në klasën e parë të shkollës fillore që kanë vijuar arsimin parafillor gjatë vitit shkollor paraprak: 53.9 % (75.5 % në nivel të Kosovës).

Shkalla neto e regjistrimit në arsimin fillor: 68.1% (91.6% në nivel të Kosovës).

Përqindja e fëmijëve të moshës së shkollës fillore që aktualisht vijojnë arsimin fillor ose të mesëm: 85.3 % (98% në nivel të Kosovës).

¹⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Komunitetet Rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës, Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishitë 2013-2014

Fëmijët në punë - Përqindja e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare, të cilët janë të angazhuar nëpunë: 16.6 % (10.7% në nivel të Kosovës).

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar Planin Strategjik për Arsimin në Kosovë (PSAK) 2017-2021, ku parashihen masa për arritjen e disa treguesve specifikë për arsimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian deri në vitin 2021:

Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në edukimin parafillor (Caku: 70%)

Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor (Caku: 95%)

Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të ulët (Caku: 85%)

Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë (Caku: 50%)

Shkalla e transicionit në arsimin e mesëm të lartë për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian (Caku: 80%)

Indeksi i paritetit gjinor për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (Caku: SHFMU – 1, SHML – 0.90)

Faktorët e ndryshëm të cilët paraqesin pengesë dhe vështirësi për nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian në shkolla, dhe njëkohësisht mund pengojnë arritjen dhe plotësimin e treguesve të PSAK më lartë, janë ndarë në 7 kategori si më poshtë:

10.1 FAKTORËT EKONOMIK

- **Pamundësia për të siguruar librat dhe materialet e tjera të nevojshme për shkollë**

Në shumicën e rasteve prindërit e intervistuar kanë deklaruar se sigurimi i materialeve të nevojshme për shkollë vazhdon të jetë sfidë. Edhe pse librat shkollor për të gjitha lëndët ofrohen nga ministria e arsimit për të gjithë nxënësit, në shumë raste nga mësimdhënësit është raportuar se nxënësit rom, ashkali ose egjiptian i kanë humbur ato përgjatë vitit shkollor. Tutje, qfarëdo materiali shkollor i nevojshëm në procesin mësimor bie mbi barrën edhe ashtu të rënduar të prindërve apo kujdestarëve të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian.

Në 3 nga 4 lokacionet e hulumtimit organizata të ndryshme jo-qeveritare ofrojnë pako shkollore për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian në secilin fillim-vit shkollor. Kjo edhe pse një ndihmë jashtëzakonisht e madhe, nuk është zgjidhje e qëndrueshme.

- **Mungesa e veshëmbathjeve**

Mungesa e veshëmbathjeve të përshtatshme për shkollë, sidomos gjatë stinës së dimrit, është një prej faktorëve që ka çuar në braktisje të shkollimit në shumë raste. Një gjë e tillë është konfirmuar nga hulumtimi në teren, ku del si një nga vështirësitë kryesore në listimin e vështirësive të përmendura nga prindërit, nxënësit, por edhe nga mësimdhënësit dhe menaxhmenti i shkollës.

- **Higjienajo e duhur personale**

Kushtet e banimit, mungesa e ujit ose reduktimet e shpeshta, numri i madh i antarëve të familjes që ndajnë të njëjtën hapësirë banimi, si dhe kushtet e rënduara ekonomike kontribuojnë në pamundësinë për të mbajtur higjiene të duhur personale. Në disa raste nga organizata të ndryshme që veprojnë në nivel lokal janë dhuruar pako higjienike¹⁹ bashkë me instruksione dhe këshilla për mbajtje të higjienës orale dhe trupore. Siq u tha më lartë në lidhje me pakot shkollore, kjo edhe pse është një ndihmë mjaftë e madhe për këto komunitete, nuk paraqet një zgjidhje të qëndrueshme.

¹⁹Në Fushë Kosovë organizata The Ideas Partnership si dhe organizata Balkan Sunflowers Kosova kanë dhuruar pako higjienike në disa raste për familjet rome, ashkali, dhe egjiptiane.

“Pesë fëmijë i kemi, tre punojnë. Më i madhi është 12 vjet. Dalin bashkë me burrin me mbledh kanaqe”, citohet në raportit e BIRN, Halide Mekolli nga fshati Plemetin.

- **Angazhimi i fëmijëve në punë në shtëpi, në rrugë, apo edhe punë tjera të rënda**

Gjendja e rëndë ekonomike e shumicës së familjeve rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë është pashmangshmërisht e ndërlidhur edhe me arsimin dhe pasojat që ka në shkollimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve. Në shumë raste fëmijët rom, ashkali ose egjiptian, braktisin shkollimin në vitet e hershme të ciklit 6-9 të shkollës fillore që të ndihmojnë familjet e tyre përmes punës dhe fitimit të të hollave.

Në një raport të BIRN të publikuar në muajin Maj të vitit 2019²⁰, paraqitet gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale e familjeve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në fshatin Plemetin, komuna e Obiliqit. Ekonomikisht familjet e këtyre komuniteteve nuk qëndrojnë më mirë as në komunat tjera. Në një raport të publikuar nga projekti KOSANA në vitin 2015, thuhet se vetëm 3.76% e popullatës rome, ashkali edhe egjiptiane në Kosovë kanë të hyra mbi 300 EUR në muaj, ndërsa pjesa më e madhe e tyre, 40.06% kanë të hyra më pak se 80 EUR në muaj. Në anën tjetër, 42% janë në asistencë sociale²¹.

20Rrëfim nga Plemetini – Fëmijët që nuk festojnë ditën e tyre
21Raporti vjetor i projektit Kosana për vitin 2015, faqe 57


10.2 ÇËSHTJE SHËNDETËSORE, QË NDËRLIDHEN ME EDUKIMIN

- **Pamundësia për të marrë trajtim të menjëhershëm shëndetësor dhe stërzgjatja e rikuperimit**

Në shumë raste njëra prej arsyeve pse nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian bëjnë mungesa të shumta, e të cilat automatikisht ndikojnë në performancën e tyre të përgjithshme dhe suksesin në shkollë, është mos-trajtimi i shpejtë dhe adekuat i problemeve të ndryshme shëndetësore. Probleme të dukshme vërehen edhe në procesin e imunizimit të fëmijëve të këto komunitete, e që në disa raste kanë rezultuar edhe me përhapje epidemike të sëmundjeve ngjitëse si fruthi. Rasti më i fundit i përhapjes së fruthit ka ndodhur në tetor të vitit 2018, ku si pasojë një foshnje disa-muajshe ka ndërruar jetë në Fushë Kosovë²². Efekti i kësaj përhapjeje të fruthit është vërejtur edhe në arsim, ku janë shënuar shumë mungesa në shkollë nga shumica e nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian, duke ndikuar kështu në thellimin e dallimeve në performancë me fëmijët shqiptar. Në anën tjetër, këto sëmundjejanë pothuajse tërësisht pjesë e së kaluarës tek komunitetet tjera në Kosovë.

- **Më shumë sëmundje ngjitëse si pasojë e mungesës së higjienës personale**

Mungesa e higjienës personale ka rezultuar si një nga arsyet e pritshmërisë shumë më të shkurtër të jetës te këto komunitete, krahasuar me jetëgjatësinë mesatare të vendit.



Grafiku 2 – Dallimi i pritshmërisë së jetës të popullatës rome, ashkali, dhe egjiptiane kundrejtë pritshmërisë mesatare të jetës në Kosovës²³.

Përveq higjienës personale, ndikim të madh ka edhe keq-ushqyerja, mungesa e veshëmbathjeve adekuate, ekspozimi ndaj ndotësve të ndryshëm dhe materialeve të ndryshme helmuese. Një fakt interesant i nxjerrur nga intervistimi i mësimdhënësve në shkollën Pandeli Sotiri, dega në fshatin Plemetin, tregon se një numër jo i vogël i nxënësve rom në këtë fshat janë dëbuar nga shkolla e cila gjendet në të njëjtin obor me Pandeli Sotirin, por që vepron në gjuhën dhe sistemin paralel serb. Arsyeja kryesore për këto dëbime del të jetë niveli jo i përshtatshëm i higjienës personale të këtyre nxënësve.

23. Raporti vjetor i projektit Kosana për vitin 2015, faqe 10

10.3 ÇËSHTJE SOCIALE

- **Varfëria ekstreme**

Sipas Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare për vitin 2017 të realizuar nga Banka Botërore dhe Agjensia e Statistikave të Kosovës, është vlerësuar se 17.6 përqind e popullsisë në Kosovë jetojnë në varfëri absolute, me më pak se 1.82 euro për një person të rritur. Ndërsa 5.3 për qind e popullsisë jetojnë në kufirin e varfërisë së skajshme, me më pak se 1.30 euro në ditë. Në kategorinë e fundit përket edhe shumica e familjeve tjera rome, ashkali, dhe egjiptiane²⁴. Ky fakt përmendet në vazhdimësi në raportet e progresit të Bashkimit Evropian për Kosovën, si dhe në raportet e Bankës Botërore për Kosovën.

- **Mungesa e përkrahjes nga ana e prindërve**

Të gjithë të intervistuarit nga grupet e menaxhmenteve të shkollave, dhe po ashtu 100% e mësimitdhënësve të intervistuar, kanë deklaruar mungesën e përkrahjes nga prindërit në mësim dhe detyra të shtëpisë për fëmijët e tyre si faktor kyç në performancën e dobët të nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollë. Kjo ndodhë për arsye se shumica e prindërve të fëmijëve në moshë për shkollim, kanë braktisur vetë shkollimin në moshë të hershme në mënyrë që të angazhohen në punë, apo edhe të martohen. Në jo pak raste, fëmijët më të mëdhenjë në moshë ndalen nga shkolla për të u përkujdesur për vëllezërit dhe motrat e tyre më të vegjël, ose për të ndihmuar në punët e shtëpisë.

Afërsisht gjysma e prindërve të intervistuar nuk marrin pjesë në takimet e organizuara nga mësuesit për fëmijët e tyre. Në të gjitha komunat që kanë qenë pjesë e hulumtimit, këshillat e shkollës dhe këshillat e prindërve kanë në përbërje anëtar nga komunitetet rom, ashkali, apo egjiptian.

- **Nënvlerësimi i shkollimit të vajzave**


Në hulumtimin e realizuar në 4 lokacionet e përzgjedhura del që shumica e prindërve me pak përjashtime, vlerësojnë shkollimin e djemve si më të rëndësishëm dhe më prioritar kundrejtë shkollimit të vajzave. Ata konsiderojnë se djemtë bartin barrën e mbajtjes së familjes me të hyra financiare, ndërsa vajzat parashihet të ndërrojnë shtëpi dhe familje kur martohen, dhe kështu investimi në shkollimin e tyre nuk shihet si investim i kthyeshëm.

Për më tepër, martesat e hershme prekin më rëndë vajzat sesa djemtë, për faktin se gjithmonë pritshmëritë janë që gruaja të jetë më e re se burri në një lidhje martesore. Në këtë mënyrë shumë vajza braktisin shkollimin para vëllezërve apo bashkëmoshatarëve tjerë të tyre meshkuj.

24. Anketa e buxhetit të ekonomive familjare, 2017

- **Fenomeni i martesave të hershme**

Martesat e hershme pengojnë emancipimin e të rinjve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, të cilat kanë ndikuar në braktisjen e shkollës dhe nivelin e ulët të arsimit tek të rinjtë e këtyre komuniteteve. Në një hulumtim të realizuar nga The Ideas Partnership në vitin 2017 në Fushë Kosovë mbi fenomenin e martesave të hershme²⁵, del se 53.57 % e respondentëve të intervistuar janë martuar nën moshën 18 vjeçare. Kjo pashmangshmërisht ka ndikuar në numrin e ulët të atyre që regjistrohen në arsimin e mesëm dhe atë universitar. Këtë e vërtetojnë edhe të dhënat e mbledhura në terren gjatë realizimit të këtij hulumtimi, sipas të cilave 99% e respondentëve nuk e kanë vazhduar arsimimin pas martesës.



Grafiku 3 – Martesat nën moshën 18 vjeçare të ndara sipas gjinisë, tek komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian në Fushë Kosovë

- **Mungesa e vetëbesimit dhe sigurisë në shkollë**

Nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian të intervistuar janë pyetur specifikisht që të tregojnë ër ofendime që u janë bërë atyre në bazë të etnisë, ngjyrës së lëkurës, apo dallimeve tjera që ata kanë me nxënësit nga komuniteti shumicë. Nga përgjigjet e nxënësve rezulton se 3/4 e të intervistuarve janë ofenduar me fjalë si “maxhup” ose “gabel”, ose edhe janë sulmuar fizikisht nga nxënës kryesisht më të mëdhenjë në moshë, që i përkasin komunitetit shumicë. Sulmet dhe ofendimet në shumicën e rasteve kanë ndodhur jashtë hapësirave të shkollës, ose edhe jashtë oborrit të shkollës. Hulumtimi gjithashtu tregon se incidentet e tilla bëhen më të shpeshta në klasat më të larta të shkollës fillore, ose edhe në shkollë të mesme.

Në jo pak raste nxënësit janë ofenduar me fjalë edhe nga mësimdhënësit e tyre. Një nga prindërit e fokus grupit në Fushë Kosovë tregon se e ka larguar vajzën nga shkolla në klasë të dytë, si pasojë e

25.Fenomeni i Martesave të Hershme në Komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Fushë Kosovës

sjelljes jo të mirë dhe efektit negativ psikologjik që mësuesja ia bënte asaj në shkollën Selman Riza. Një rast tjetër që raportohet ndarazi, por me përputhje të plotë në deklarata të tyre nga nxënësit dhe prindërit në fshatin Plemetin në Obiliq, lidhet me një arsimtare lëndore në shkollën Pandeli Sotiri në Obiliq e cila duke reaguar për sjelljet e papërshtatshme të disa nxënësve ashkali, ju thot që *“do të ju kisha rrah po nuk po du me i fëlliq duart se jeni të djersitur”*.

Gjatë intervistimit të mësimit të nxënësve është vërejtur se shumica e tyre konsiderojnë se higjiena e ulët personale, braktisja e hershme e shkollimit, mos-interesimi nga ana e prindërve, janë gjëra normale që i përcjellin romët, ashkallitë, dhe egjiptianët, dhe për më tepër konsiderojnë se janë karakteristike të tyre. Ky fakt është shumë shqetësues, dhe kur ndërlidhet me aspekte tjera të diskriminimit të nxënësve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilat ndodhin në baza ditore pa nxitur reagime nga pothuajse askush, përbën një situatë alarmante.

10.4 PROBLEME NË TË MËSUAR

- **Mungesa e bazës dhe mbetja prapa në mësim kundrejtë bashkëmoshatarëve**

Nga të dhënat e raportit vlerësues mbi edukimin parashkollor në Kosovë²⁶ të publikuar në Nëntor të vitit 2018 nga projekti KEEN, 90.1% të fëmijëve ose 24,308 nga 26,977 fëmijë të moshës 5 vjeçare në Kosovë janë regjistruar në klasat parafillore, dhe vetëm 4.8% ose 6,760 fëmijë të moshës 0-4 vjeç nga 139,961 janë regjistruar në klasat parashkollore për vitin akademik 2018/2019.

Nga këta fëmijë, vetëm 357 fëmijë rom, ashkali, dhe egjiptian janë regjistruar në klasat parafillore. Niveli i ulët i përfshirjes së fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian në klasat parashkollore dhe parafillore, është “parakusht” për krijimin e hendekut në performancë dhe mësim-nxënie në mes të nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian kundrejt atyre shqiptar.

Situata fatkeqësisht nuk përmirësohet me fillimin e klasës së parë, sepse në shumicën e rasteve nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, duke mos pasur përkrahjen e prindërve në shtëpi dhe shpeshherë as përkrahjen e duhur të mësimdhënësve në klasat e hershme, fillon dhe krijohet një hendek në mes të performancës së tyre dhe nxënësve të komunitetit shumicë.

- **Problemet e padiagnostifikuara në shikim, dëgjim, si dhe aftësi të tjera të kufizuara**

Në një hulumtim të realizuar nga projekti EDI 2 në komunat e Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, dhe Shtimes mbi numrin dhe nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë²⁷, del që në shumicën e rasteve prindërit nuk mund të japin përgjigje të saktë lidhur me pa-aftësinë e fëmijëve të tyre. Të gjeturat e këtij hulumtimi gjithashtu tregojnë që mbështetja akademike shtesë dhe pritshmëritë më të për fëmijët e tyre nga ana e mësimdhënësve, shihet si diçka me rëndësi të madhe për suksesin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Tutje, kontrollat sistematike mjekësore që duhet të i paraprijnë regjistrimit në klasë të parë, nuk realizohen për shumicën e fëmijëve rom, ashkali, dhe egjiptian. Në këtë mënyrë mësimdhënësit gjenden në një situatë jo të favorshme, duke e pasur të pamundur të përshtasin teknikat dhe metodologjinë e punës për të përfshirë sa më shumë fëmijët me probleme në shikim, në dëgjim, probleme në të nxënë, apo edhe ndonjë aftësi të kufizuar të caktuar.

²⁶Raporti vlerësues mbi edukimin parashkollor në Kosovë - Projekti KEEN

²⁷Fuqizimi i komuniteteve minoritare në Kosovë përmes Edukimit, Dialogut për Gjithëpërfshirjes në proceset vendim-marrëse – Projekt i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADC) në Kosovë, dhe implementuar nga konzorciumi i OIQ-ve Balkan Sunflowers Kosova, The Ideas Partnership, dhe PLAY.

- **Problemet në nxënie për lëndë të caktuara**

Rezultatet e hulumtimit në teren vështirë se nxjerin ndonjë lëndë të caktuar si më problematike se lëndët tjera. Megjithatë është vërejtur gjatë intervistimit të nxënësve, por edhe të mësimit, se lëndët më teorike paraqesin pak më shumë problem sesa lëndët që përmbajnë më shumë aktivitete praktike.

3/4 e nxënësve të intervistuar kanë deklaruar se në shumë raste kanë problem të kuptojnë instruksionet që ipen nga mësimit në gjuhën shqipe, por edhe atë angleze. Kjo për faktin se mësimit përdorin gjuhë të standardizuar në shumicën e rasteve, e cila dallon në masë të dukshme nga gjuha të cilën këta nxënës e flasin në shtëpi.

Në disa raste mësimit e kanë ngritur çështjen e mbështetjes së nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në lëndët e edukatës fizike dhe muzikës, qoftë ajo mbështetje përmes orëve plotësuese nga vetë ata, apo përmes programeve të qendrave për mësimit-nxënie. Kjo për faktin se në numër të dallueshëm, nxënësit rom, ashkali, ose egjiptian, kanë performuar dukshëm më mirë se nxënësit shqiptar në lëndët e lartëcekura, kanë deklaruar mësimit e intervistuar.

- **Mungesat në orë të mësimit**

Fenomeni i mungesave të shumta vazhdimisht i ka përcjellur nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian. Për më tepër ky faktor ka ndikuar edhe në braktisjen e shkollimit nga një numër i madh i këtyre nxënësve. Në të gjitha rastet tjera, mungesat e shumta kanë dëmtuar procesin e konsolidimit të tyre në procesin mësimit, duke i kontribuar hendekut në mes tyre dhe nxënësve shqiptar apo serb të krijuar nga përfshirja e ulët në klasat parashkollore dhe parafillore, si dhe nga mungesa e përkrahjes nga prindërit e tyre në shtëpi.

Gjatë intervistimit të nxënësve nëpër fokus grupe, është mësuar që së paku 3/4 e tyre kanë bërë mungesa të paraarsyeshme gjatë vitit të fundit në numër të konsiderueshëm. Për më tepër, është vërejtur se mungon arsyetimi nga ana e tyre për rëndësinë e mos shënimit të mungesave të tilla, duke konsideruar mungesat si diçka përgjithësisht normale.

Disa nga arsyet që qojnë në numër të lartë të mungesave janë çështjet shëndetësore, planet familjare të cilat bëhen duke marrë pak ose fare parasysh shkollimin e fëmijëve, qofshin ato për vizita familjare apo pushime verore, mungesa e veshëmbathjeve, mungesa e transportit, mungesa e detyrave të shtëpisë, dhe frika nga penalizimet e ndryshme nga mësimit.

Në shumë raste kur nxënësit kanë munguar për disa ditë, frika nga ndëshkimi i mësimit ka çuar ata të braktisin totalisht mësimit.

Nga ana tjetër, mësimit e intervistuar janë ankuar të gjithë për numrin e lartë të mungesave nga nxënësit e këtyre komuniteteve. Si pasojë, ata kanë hasur në probleme me implementimin e programit të tyre, dhe në këtë mënyrë duke u munduar të ofrojnë mbështetje shtesë për nxënësit që

kanë munguar për disa ditë, ata në disa raste kanë dëmtuar nxënësit e rregulltë me mungesë vemendjeje për ta.

Prindërit, të pyetur për arsyet e mungesave të fëmijëve të tyre në shkollë, deklarojnë mungesën e vullnetit të fëmijëve për të shkuar në shkollë, mungesën e vetëdijës së tyre mbi rëndësinë e shkollimit të fëmijëve të tyre, planifikimin e vizitave familjare jashtë qyteteve dhe fshatrave ku jetojnë, pa marrë për bazë orët që fëmijët e tyre humbin, dhe kështu me radhë.

10.5 DISKRIMINIMI

- **Nga ana e mësimit: Ndarja në klasa, nënçmimi, mungesa e përkujdesjes dhe vëmendjes**

Në të gjitha komunat ku është realizuar intervistimi në fokus grupe, është raportuar një qasje jo e duhur e mësimit ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian. Raportime për raste të keqtrajtimit nga ana e mësimit janë raportuar nga prindërit dhe nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian në Obiliq dhe Fushë Kosovë, komuna këto pjesë të hulumtimit. Megjithatë raste të shumta janë dokumentuar edhe në komuna dhe fshatra tjera ndër vite.

Ngacimet apo keqtrajtimet kanë forma të ndryshme. Në disa raste mësimit injorojnë nxënësit e këtyre komuniteteve, dhe zhvillojnë procesin mësimor duke i përfshirë ata pak ose fare. Në raste tjera, mësimit kanë nënçmuar nxënësit rom, ashkali, egjiptian me fjalë.

Në të gjitha rastet, mësimit është raportuar se kanë mungesë të përkujdesjes dhe vëmendjes ndaj nxënësve të komuniteteve në procesin mësimor. Kjo mungesë e vëmendjes është raportuar edhe në disa raste të sistemit të nxënësve në rreshta apo në grupe brenda klasave. Megjithatë, në observimet e rastësishme klasore të mundësuar në Shtime, Fushë Kosovë, dhe Obiliq, kjo gjë nuk është vërejtur në asnjërën klasë të observuar.

- **Nga ana e bashkëmoshatarëve të tyre: ngacimi, përjashtimi, e forma tjera të bullizmit**

3/4 e nxënësve të intervistuar kanë deklaruar se janë ngacmuar nga bashkëmoshatarët e tyre ose nga nxënës më të mëdhenjë në shkollat përkatëse. Në shumë raste, ata janë ofenduar me fjalë dhe shprehje raciste, dhe në rastet më të lehta ata janë përjashtuar nga shoqëria në aktivitete të ndryshme shkollore por edhe sociale brenda dhe jashtë shkollës.

Një nga nxënësit e intervistuar në Fushë Kosovë tregon se edhe pse ka shoqëri shumë të mirë në shkollë me një shok klase shqiptar, ata asnjëherë nuk kanë vizituar njëri tjetrin në shtëpitë e tyre, përderisa kjo gjë thot se është e shpeshtë në mes të bashkëmoshatarëve shqiptar ose ashkali.

Në disa raste në Plemetin të Obiliqit, nxënësit ashkali nuk janë lënë të dalin në pushim të gjatë në koridor apo obor të shkollës, dhe janë mbyllur në klasa nga nxënësit shqiptar derisa ata janë ndihmuar nga mësimit ose nxënësit tjerë shqiptar të cilat janë shokë të tyre të klasës.

- **Ngacmimet rrugës për në shkollë, apo nga shkolla, si dhe në oborr të shkollës**

Ngacmimet, ofendimet, përjashtimet, dhe neglizhimi që iu bëhen nxënësve rom, ashkali, dhe egjiptian në shkollë nga mësuesit dhe nxënësit tjerë, nuk janë të incidente të izoluar në ambientet e shkollës.

Në të gjitha komunat ku janë organizuar fokus grupe me nxënës, ata kanë raportuar se janë ngacmuar të paktën një herë rrugës për në shkollë ose nga shkolla për në shtëpi nga kalimtar të rastit me fjalë ofenduese dhe raciste. Për më tepër shumica e rasteve të konflikteve në mes nxënësve nuk ndodhin në ambientet e brendshme të shkollës, por në oborr të shkollës ose rrugëve në afërsi të shkollës.

Vlenë të përmendet se në gjimnazin “Hivzi Sylejmani” të Fushë Kosovës, vitin e kaluar janë identifikuar 5 raste të braktisjes së shkollimit nga organizata lokale Balkan Sunflowers Kosova, si pasojë e incidenteve dhe ngacmimeve të nxënësve ashkali në këtë gjimnaz.

10.6 GJUHA

- **Shkollimi në gjuhë tjetër prej asaj amtare (kryesisht komuniteti rom)**

Shumica e nxënësve të komunitetit rom në komunën e Prizrenit shkojnë në shkollë në gjuhën shqipe. Në këtë aspekt, nxënësit mund të mësojnë gjuhën rome si një nga lëndët shkollore. Mësimdhënësit e gjuhës rome janë të pakët, dhe përballen me sfida të shumta sa i përket librave dhe materialeve tjera për organizimin e orëve mësimore në këtë gjuhë²⁸.

"Shoqëria nuk ka investuar në krijimin e kushteve që të zbatohet e drejta e tyre kushtetuese për përdorimin e gjuhës në të gjitha nivelet, që nga shkollimi parafillor e deri te ai universitar. Andaj mendoj se në këtë drejtim romët janë të diskriminuar". Bexhet Shala, drejtor i Këshillit për Lirinë dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Pjesa tjetër e nxënësve të komuniteteve, kryesisht atij rom, shkojnë në shkollë në gjuhën serbe dhe shkollat që kryesisht funksionojnë në sistemin serb. Në këto shkolla mësimi zhvillohet tërësisht në gjuhën serbe, dhe gjuha rome nuk ofrohet as si lëndë zgjedhore.

28. Gjuha rome, gjuha më e diskriminuar në Kosovë, artikulli mbi gjuhën rome në Evropa e Lirë

10.7 QASJA

- **Distanca dhe vështirësitë tjera në qasjen në shkollë**

Përveq faktorëve të elaboruar më lartë në listën e gjatë të vështirësive me të cilat përballen nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, hyjnë edhe shumë pengesa fizike që lidhen me qasjen e tyre në shkollë. Ndër vështirësitë kryesore të evidentuara në intervistimet në fokus grupet e realizuara në 4 komuna, del të jetë distanca nga shkolla. Në Fushë Kosovë organizata lokale The Ideas Partnership ka ndihmuar pjesërisht në zgjidhjen e këtij problemi duke paguar një autobus për transportimin e nxënësve gjatë stinës së dimrit nga Lagjia 29 deri në oborrin e shkollës “Selman Riza”, dhe anasjelltas.

Përveq distancës nga shkolla, nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian, sidomos në Fushë Kosovë dhe Obiliq, përballen me vështirësi të tjera në rrugë. Qentë endacak, mungesa e ndriçimit në rrugë, dhe mos-pastrimi i rrugëve gjatë stinës së dimrit nga dëbora dhe akulli, paraqesin vështirësi të mëdha në qasjen e tyre në shkollë.

Gjatë observimeve të ndryshme, të organizuara ose të rastësishme në ambientet shkollore në të gjitha komunat e përfshira në hulumtim, është vërejtur se ambientet e brendshme janë të mbushura me punime të ndryshme që shpërfaqin historinë dhe kulturën shqiptare në Kosovë. Fatkeqësisht në asnjë rast nuk është vendosur punime që tregojnë kulturën dhe historinë e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian në Kosovë dhe në botë. Kjo sigurisht ndikon në krijimin e një ambienti jo edhe aq mirëseardhës për këta nxënës, dhe në një mënyrë ndikon në asimilimin e tyre kulturor.

11 REKOMANDIME

- Në nivelet fillor dhe të mesëm të ulëttë shkollimit të punohet më shumë me nxënësit e këtyre komuniteteve (edhe përmes mësimit shtesë e mësimit plotësues), në mënyrë që sukcesi i tyre të përmirësohet dhe ata të jenë në gjendje të regjistrohen në drejtime që ju pëlqejnë dhe të jenë të suksesshëm gjatë shkollimit.
- Mësimdhënësit të fokusohen në lëndë dhe shkathtësi të caktuara që nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian kanë, në mënyrë që atyre të u ipet një
- MASHT të zbatojë kornizën ligjore për funksionimin e Qendrave Mësimore, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr.19/2018 për Themelimin dhe Funksionimin e Qendrave Mësimore.
- Institucionet lokale në bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare të funksionalizojnë ekipet për parandalim dhe reagim në rast të braktisjes dhe mos-regjistrimit në shkollë duke siguruar pjesëmarrjen e prindërve dhe përfaqësuesve të Qendrave Mësimore në këto ekipe.
- Stafi i Qendrave Mësimore të mbledhin në mënyrë sistematike të dhëna dhe tregues lidhur me të arriturat arsimore të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në shkollë me qëllim të monitorimit të punës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër të shkollës.
- Stafi i Qendrave Mësimore të mbledhin të dhëna në mënyrë sistematike dhe të monitorojnë sigurinë e përgjithshme në shkollë për nxënësit rom, ashkali, dhe egjiptian, në mënyrë që rastet e ofendimeve, ngacmimeve dhe sulmeve fizike në shkollë të parandalohen dhe trajtohen.
- Shkollat të rrisin bashkëpunimin e tyre me prindërit dhe komunitetin në mënyrë që të arrihet një ndikim më i madh në ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tyre, si dhe përfshirjes sociale.
- Fushata vetëdijesuese dhe informuese për prindërit, në mënyrë që ata të vetëdijesohen për rëndësinë e shkollimit të fëmijëve pavarësisht kushteve të rënda ekonomike dhe të mos i ndalin fëmijët nga shkolla për të punuar, për lëmoshë, apo për të bërë punët e shtëpisë.

- Donatorët dhe institucionet lokale e qendrore t'i përkrahin nxënësit e familjeve me gjendje tërëndë sociale me pako shkollore dhe me veshmbathje.
- Mësimdhënësit klasor dhe ata lëndorë duhet të trajnohen për të qenë më të informuar mbi rëndësinë e ruajtjes së diversitetit, si dhe të kenë qasje sa më përfshirëse për nxënësit e këtyre komuniteteve.
- Fushata vetëdijesuese për prindërit me qëllim të zhdukjes së fenomenit të martesave të hershme.
- Mësimi tërëditor ndihmon në evitimin e angazhimit në punë të fëmijëve dhe u jep kohë dhe hapësirë mësimdhënësve që të jenë më pranë nxënësve për qfarëdo vështirësie që ata kanë në mësimnxënie.
- Nga organizata RADC – Roma and Ashkali Documentation Center është raportuar se në pjesën veriore të Kosovës, në sistemin serb të edukimit brenda kësaj pjese, komuniteti rom trajtohet ndryshe në shkollë dhe me ta nuk punohet me kurrikulën e njëjtë sikur me fëmijët serb në këtë pjesë. Rekomandohet që institucionet e Republikës së Kosovës, respektivisht inspektoriat i arsimit të dalë në teren për të vërtetuar këto raportime të organizatës RADC.
- Të zhvillohen programe të ndryshme të ko-gjenerimit të projekteve të vogla brenda shkollës ku fëmijët janë të përfshirë, qofshin ato shfaqje teatrale, krijim dokumentarësh të shkurtër, apo aktivitete tjera në komunitet. Kjo do të ndihmonte që prindërit të aktivizohen dhe të përfshihen më shumë gjatë prezentimit të këtyre projekteve dhe aktiviteteve, e që në vete paraqet mundësi shumë të mirë të diskutimit të çështjeve të ndryshme në interes të shkollimit të fëmijëve të tyre.
- Mësimdhënësit dhe menaxhmenti i shkollës duhet të marrin trajnim për aftësimin e tyre në angazhimin për një shkollë pa racizëm dhe ksenofobi. Do të ishte mire që MASHT dhe DKA-të në secilën komunë me përbërje etnike të përzier të angazhohen për të ofruar module trajnimi mbi luftimin e racizmit dhe ksenofobisë në shkolla.



ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council